



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 127

**Tiranë – E hënë, 5 qershor 2017**

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Ministrisë së Punëve të Jashtme nr. 8351, datë 5.6.2017	6467
Për botimin e datës së hyrjes në fuqi të dy marrëveshjeve.....	6467
Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Ermal Xhelo.....	6467
Kërkesë për ndreqjen e një gabimi material në tekstin e vendimit nr. 473, datë 1.6.2017, të Këshillit të Ministrave, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126, viti 2017.....	6467

**NJOFTIM**

Nr. 8351, datë 5.6.2017

**PËR BOTIMIN E DATËS SË HYRJES NË  
FUQI TË DY MARRËVESHJEVE**

Më datën 5 maj 2017 kanë hyrë në fuqi marrëveshjet ndërkombëtare si vijon:

- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011, 2013, 2014, për projektin “Program për menaxhimin e mbetjeve”, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 30/2017, i cili është shpallur me dekretin nr. 10119, datë 7.4.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Financiar 2016 për projektin “Program për menaxhimin e mbetjeve II”, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 31/2017, i cili është shpallur me dekretin nr. 10120, datë 7.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM  
I MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME  
**Gazmend Barbullushi**

**KËRKESË**

Shtetësja Vajde Xhelo, e datëlindjes 18.1.1949, kërkon përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë shpalljen të vdekur të shtetasit Ermal Xhelo, i biri Patriotit dhe i Vajdes.

KËRKUESJA  
**Vajde Xhelo**

**NDREQJE GABIMI**

Në vendimin nr. 473, datë 1.6.2017, të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017”, të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 126, viti 2017, f. 6457, konstatohet një gabim material, konkretisht në pikën 19 të vendimit, fjala “... **iniciuar** ...” duhet të ishte “... **mos iniciuar** ...”.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 28 lekë